



VENDIM

Nr. 12, Datë 19.01.2017

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “M.C INERTE LUMZI” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “TUÇ” ME FUQI 4470 KW DHE HEC “LUMZI” ME FUQI 11000
KW, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 15470 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”a” të Ligjit nr.43/2015, ” *Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”; neneve 5, gërma ” a”; 13 dhe 21 të ” *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të ” *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “M.C INERTE LUMZI”sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Tuç” dhe ” Lumzi”, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorim të Tregut,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë M.C INERTE LUMZI sh.p.k., plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat ” a”, ” b”, ” c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat ” a”, ” b”, ” c”, ” d”, ” e”, ” f”, ” g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat ” a”, ” b”, ” c”, ” d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “M.C INERTE LUMZI sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Tuç” me fuqi 4470 KW dhe Hec “Lumzi” me fuqi 11000 KW, me fuqi totale të instaluar 15470 KW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI